



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

VENDIM

Nr. 512, date 31.5.2006

PER

**PROCEDURAT E KRYERJES SE KONTROLLIT TE
NDIHMES EKONOMIKE, TE PAGESES SE AFTESISE
SE KUFIZUAR DHE SHERBIMEVE SHOQERORE**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes dhe te pikes 3, te nenit 27, te ligjit nr.9355, date 10.3.2005, "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore", me propozimin e ministrit te Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Keshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

**ORGANIZIMI, OBJEKTI DHE RAPORTI I KONTROLLIT TE
NDIHMES EKONOMIKE, PAGESES SE PERSONAVE ME AFTESI
TE KUFIZUAR DHE SHERBIMEVE SHOQERORE**

1. Kontrolli i sherbimeve shoqerore, organizohet dhe kryhet nga Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Personal me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore, ne baze te procedurave te percaktuara ne kete vendim.
2. Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore eshte i organizuar dhe funksionon ne nivel qendror dhe rajonal.
3. Kontrolli bazohet ne planin vjetor dhe ne programin mujor te punes. Programi i kontrollit pergatitet nga grupi i kontrollit dhe miratohet nga titullari i institucionit.

4. Programi i kontrollit duhet te permbaje:
 - a) Subjektet, qe do te kontrollohen;
 - b) Llojin e kontrollit, qe do te ushtrohet;
 - c) Periudhen, per te cilen do te behet kontrolli;
 - c) Objektivat, qe duhet te realizohen.
5. Kontrolli programohet per çdo muaj dhe mund te jete i plote ose tematik. Ne çdo rast, perpara kryerjes se kontrollit, drejtuesi i grupit te kontrollit njofton me shkrim subjektin per fillimin e kontrollit, qellimin, si dhe objektivat qe do te realizohen.
6. Kontrolli mund te jete i paparalajmeruar, ne rastet kur ka sinjalizime per abuzime ose shkelje ligjore nga subjekti perkates.
7. Sinjalizime konsiderohen:
 - a) Ankesat me shkrim te klienteve, qe perfitojne sherbimet e subjektit perkates;
 - b) Njoftime me shkrim ose me mjete te tjera komunikimi te personave te interesuar per veprimtarine e subjektit, pasi ky veprim te jete vleresuar si joabuziv;
 - c) Njoftime ose ankime, te çdo forme, nga entet publike.
8. Raporti perfundimtar i kontrollit behet nga grupi i kontrollit, i cili vlereson ose jo komentet e subjektit te kontrolluar. Ne perfundim te kontrollit, nje kopje e raportit i dorezohet subjektit te kontrolluar. Nese nga raporti perfundimtar i kontrollit, vihen ne dukje shkelje te legjislacionit, Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Persona me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore, propozon njeran nga masat e meposhtme:
 - a) Pezullimin e veprimtarise se subjektit deri ne plotesimin e standardeve perkatese;
 - b) Mosrinovimin e licences per ushtrimin e veprimtarise;
 - c) Heqjen e licences per ushtrimin e veprimtarise dhe mbylljen e saj;
 - c) Fillimin e procedurave per shlyerjen e demit te shkaktuar, ne zbatim te legjislacionit civil dhe legjislacionit te veçante;
 - d) Masen disiplinore, per personal pergjegjes ne subjektet publike, te cilet kane shkaktuar demin apo kane shkelur dispozitat, ligjore dhe nenligjore, ne fuqi, nese veprimtaria e subjektit bie ndesh me Kodin e Procedurave Administrative;
 - dh) Fillimin e procedurave nga autoriteti pergjegjes, kur mendohet se jane konsumuar elements te vepres penale.
9. Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Persona me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore, pas heqjes se licences kerkon prane gjykates shperndarjen e shoqates ose fondacionit, sipas parashikimeve te kreut II, te ligjit Nr.7850 date 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", te ndryshuar.
10. Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Persona me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore per subjektet juridike, shoqerite tregtare, njofton organet tatimore per heqjen e licences se subjektit perkates.

KREU II

PROCEDURAT E KONTROLLIT TE NDIHMES EKONOMIKE DHE PAGESES SE AFTESISE SE KUFIZUAR

1. Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Personat me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore kontrollojnë:
 - a) veprimtarine e seksionit ose te zyres se ndihmes ekonomike, pageses se aftesise se kufizuar, perkatesisht, ne bashki/komune;
 - b) zbatimin e legjislacionit perkates per ndihmen ekonomike dhe pagesen e aftesise se kufizuar;
 - c) vertetesine e dokumentacionit te paraqitur nga pretenduesit per perfitimin e ndihmes ekonomike dhe te pageses se aftesise se kufizuar;
 - ç) verifikimin e kryer nga administratoret, kur gjykohet e nevojshme, si dhe ben intervistim ose vizite ne familje, te perfituesve te ndihmes ekonomike;
 - d) verifikimin/intervistimin e personave me aftesi te kufizuar, ballafaqimi e tyre me vendimin e komisionit;
 - dh) perputhjen ndermjet listepagesave dhe thesarit, numrit te familjeve perfituese dhe shumave te perfitimit te ndihmes ekonomike dhe pageses per aftesine e kufizuar;
 - e) sakesine e te dhenave ne planifikimin e nevojave per fonde;
 - ë) menyren e planifikimit te fondit te ndihmes ekonomike dhe te fondeve per pagesen e aftesise se kufizuar;
 - f) numrin dhe shperndarjen e fondeve te ndihmes ekonomike, pageses per aftesine e kufizuar nga keshilli i bashkise/komunes.
2. Inspektoret e ketij inspektorati pas çdo kontrolli hartojne aktkontrollin per njesine e kontrolluar.
3. Per te gjitha rastet e shkeljeve ligjore te verejtura, grupi i kontrollit njofton me shkrim prefektin.
4. Grupi i kontrollit paraqet ne administrate e kryetarit te bashkise/ komunes materialin permbledhes te rezultatit te kontrollit, ku evidentohen te gjitha shkeljet e vena re nga administrata e qeverisjes vendore apo keshilli i pushtetit vendor, qe lidhet me zbatimin e legjislacionit per dhenien e ndihmes ekonomike dhe pageses per aftesine e kufizuar, si dhe propozimet perkatese per permiresimin e gjendjes dhe per masat per personal pergjegjes, te cilat jane:
 - a) gjobe, sipas neneve 5 dhe 6, te ligjit nr.7697, date 7.4.1993, "Per kundervajtjet administrative;
 - b) verejtje me shkrim;
 - c) propozim per largim nga puna;
 - ç) propozim per fillimin e procedurave nga autoriteti kompetent, ne rastet kur mendohet se jane konsumuar elementet e vepres penale ose te kundervajtjes penale.

5. Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Persona me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore, qe vepron ne nivel qendror, kontrollojne, çdo vit veprimtarine e inspektorateve, qe veprojnë ne nivel rajonal dhe, duke zbatuar metoden me zgjedhje, kontrollojne edhe veprimtarine e njesive te qeverisjes vendore.
6. Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Persona me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore ne nivel rajonal kontrollojne te gjitha njesite e qeverisjes vendore, ne perputhje me programin e kontrollit, te percaktuar ne piken 4, te kreut I, te ketij vendimi.
7. Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Persona me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore, ne nivel qendror dhe rajonal, kontrollojne programin e fondeve e menyren dhe perdorimit te tyre, respektimin e destinacionit te fondeve, te ndihmes ekonomike dhe pageses per aftesine e kufizuar dhe, per shkeljet e vena re, mund te propozojne nderprerjen e fondeve.

KREU III

PROCEDURAT E KONTROLLIT TE SHERBIMEVE TE PERKUJDESJES SHOQERORE

1. Programi i kontrollit te sherbimeve te perkujdesjes shoqerore, qe ofrohet nga subjektet perkatese, ne sektorin, publik dhe privat, te jete sipas pikes 4, te kreut I, te ketij vendimi.
2. Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Persona me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore kontrollojne:
 - a. plotesimin e standardeve te sherbimit, sipas legjislacionit ne fuqi;
 - b. zbatimin e legjislacionit ne fuqi, sipas natyres se sherbimeve qe kryhen;
 - c. dokumentacionin e çdo personi, qe perfiton sherbime;
 - ç. kushtet higjieno-sanitare te institucionit;
 - d. dokumentacionin e nevojshem te personelit, qe ofron sherbimin.
3. Ne institucionet e sherbimeve rezidenciale, ne perputhje me specifikën e ketyre sherbimeve, mund te behen kontrole edhe naten.
4. Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Persona me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore kontrollojne veprimtarine e te gjitha subjekteve, qe ofrojne sherbime te perkujdesjes shoqerore, te pakten dy here ne vit. Vleresimi i cilesise se sherbimeve te ofruara behet ne baze te plotesimit te standardeve, te veçanta dhe te pergjithshme, te parashikuara nga legjislacioni perkates.
5. Ky inspektorat, per shkeljet e vena re ose per moszbatimin e standardeve te sherbimeve te ofruara, cakton detyra dhe afate per permiresimin e situates.

6. Grupi i kontrollit harton projektraportin per kontrollin e kryer dhe nje kopje ia dorezon subjektit te kontrolluar, i cili, brenda nje afati 10 dite pune, paraqet verejtjet apo kundershite e veta per kete projektraport. Gjate kesaj faze realizohet nje takim, ku diskutohet me palen e kontrolluar.
7. Per te gjitha shkeljet e vena re, Inspektorati i Nihmes Ekonomike, Pageses per Persona me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore njofton Ministrine e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta dhe paraqet ne administraten e prefektit raportin permbledhes te rezultateve te kontrollit te kryer.
8. Subjekti i kontrolluar nga Inspektorati i Ndhimes Ekonomike, Pageses per Persona me Aftesi te Kufizuar dhe Sherbimeve Shoqerore, ka te drejte te ankohet sipas dispozitave ligjore, te parashikuara ne Kodin e Procedurave Administrative.
9. Ngarkohen Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta dhe Ministria e Brendshme per nxjerrjen e udhezimit ne zbatim te ketij vendimi.
10. Ngarkohen Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Ministria e Brendshme dhe organet e qeverisjes vendore per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

